

## STATUTI

### (I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR)

Duke u bazuar ne ligjin nr. 9901 date 14-04-2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ne ligjin nr. 9723 date 03-05-2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", une, , Medin Çulaj , atesia Haxhi , lindur 10.11.1951 , banues ne Shkoder me ltnj 028734538 , ortak I vetem I shoqerise " DENIS-SH "sh.p.k. e regjistruar prane QKR me Nipt K57022002R , me vullnetin tim te lire nenshkruaj Statutin e ri te shoqerise "DENIS-SH"sh.p.k.

#### NENI 1 FORMA E SHOQERISE

Kjo shoqeri do te jete "Shoqeri Tregtare" e formes "Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" (sh.p.k.). Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saje tregtare ne perputhje te plote me legjislacionin Shqiptare ne fuqi si dhe ate tregtare, civil, doganor. Tatimor, fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nenligjore specifike per ushtimin e saje, sipas objektit te veprimtarise se saje, mbi bazen e Aktit – Themelimit dhe Statutit te saj dhe normal e te drejtes tregtare nderkometare.

#### NENI 2 KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e kesaj shoqerie do te jete PA AFAT. Me Vendim te Asamblese se pergjithshme (te ortakut te vetem/apo ortakeve) kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te shoqerise mund te ndryshoje dhe ky Vendim I dergohet menjehere per depozitim Q.K.R.

#### NENI 3 EMERTIMI TREGTARE

Kjo shoqeri do te quhet "DENIS-SH"sh.p.k. Shoqeria ka dhe vulen e saj ne te cilen shkruhet: "DENIS-SH"sh.p.k.

#### NENI 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti I veprimtarise ekonomike te kesaj shoqerie eshte:

1. –Projektim dhe zbatim i veprave ndertimore si vijon: ndertime me karakter civil dhe ekonomik,punime/germime dhe sistemime dheu, tarracime,terenesh, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndertime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndertime terrenesh, ndertime rruges, asfaltme, hapje kanalesh si dhe cdo ndertim tjeter me karakter civil dhe ekonomik si hapje kanalizime, ndertim ujesjellesash ,etj

- Prodhim e tregtim me shumice e pakice te materiale inerte si beton, asfalto- beton etj.

- Shtrime rruges dhe riparime me beton, asfalto beton ose me materiale te tjera te perdorura per kete qellim.

- Ndertim dhe shtrirje te rrjeteve te gazit natyror.

-Zhvillimi dhe ndermjetesimi i projekteve per rikonstruksionin e ndermarrjeve industriale, Sigurimi i projekteve industriale, ashtu si edhe strukturimi i kontratave afatgjata per levrime dhe mbi bazen e ketij rfinansimi dhe kreditimi,ndermjetesimi, nxjerrja dhe perpunimi i lendeve te para te perdorura per ndertim te te gjitha llojeve dhe veprimtari sherbimi per llogari te personave te trete

-Prodhimi dhe tregtimi me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit import eeksport i tyre brenda dhe jashte vendit per llogari te vete shoqerise si dhe te treteve ku perfshihen inerte, gure, gure dekorative, gelqere, pllaka parafabrikate, llaç,çimento,rere,granile te fraksioneve te ndryshme si dhe çdo material tjeter qe nuk eshte permendur ketu por perdoret per ndertim.

-Tregtim me shumice e pakice e çdo lloj paisjeje dhe makinerie qe perdoret ne fushen e ndertimit



-Hapje e zyrave, organizimin e kurseve dhe mbajtjen e seminareve me qellim zbatimin e rregullave te siguriomit teknik ne fushen e ndertimeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe normat e Komunitetit European

-Tregtim me shumice e pakice i mallrave ushqimore, industriale, paisje elektroshtepiake, produkte bujqesore dhe blegtorale, konfeksione paisje elektroshtepiake, pjese kembimi etj

-Prodhimi i mallrave ushqimore dhe industriale dhe i lendes se pare per to ne vend si dhe kontraktimi per kete qellim

-Veprimtari ne fushen e transportit te mallrave brenda dhe jashte vendit me mallra te vete Shqerise dhe te te treteve

-Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, eletroshtepiake ushqimi social etj

-Importimi, eksportimi i produkteve te gatshme dhe gjysem te gatshme si dhe i lendeve te para per to si dhe kontraktimi me persona te ndryshem fizike apo juridike, vendas apo te huaj per kete qellim:

-Tregtimi me shumice e me pakice i konfeksioneve, per burra dhe gra te te gjitha llojeve te veshjeve(kostume, pantallona, xhaketa, pulovra, bluza, te brendshme, etj) si dhe aksesoret qe lidhen me keto konfeksionesi(kepuce, canta, ora)etj

-Tregtimi me shumice dhe pakice i artikujve kozmetik, parfumeri si dhe cdo artkull tjeter qe perfshihet ne kete fushë

-Tregtimi me shumice e me pakice i pijeve alkolike , artikuj prej druri, makineri e paisje si dhe pjese kembimi te tyre

-Shfrytezim Pyjesh, pyllezim permiresime , luftim semundjesh ne pyje sistemim malor e mbareshtim pyjesh

-Kontraktimi me persona fizike dhe/ose juridike vendas dhe/ose te huaj per gjetjen e tregjeve te shitjes dhe prodhimet e shoqerise

-Prodhimi i materialve te ndertimit

-Nxjerrja, riparim dhe rritja e drurit dhe perpunim i tij

-Prodhim dhe tregtim dyer dritare druri per vehte e per te tretet

- Eksport dhe/ose import i te gjitha prodhimeve te mesiperme

#### NENI 5 SELIA E SHOQERISE

Kjo shoqeri do te kete seline e vet ne adresen: ne Shkoder , A.Kondi (I Perash). Shoqeria ka te drejte te hape filial kudo ne Shqiperi dhe jashte saj.

#### NENI 6 KAPITALI I THEMELTARE

Shuma e kapitalit themeltar te kesaj shoqerie do te jete 100.000 leke . Ky ndahet ne 100 kuota secila me vlere 1.000. leke te reja.

Shoqeria çel llogari bankare ne lek vendi dhe çdo lloj valute, ne banke vendase ose te huaja private apo shtetere, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj. Ortaku I vetem dhe administrator I caktuar prej saj, depozitojne faksimilet e firmave te tyre origjinale ne bankat ku eshte çelur llogaria.

#### NENI 7

Pjeset e kapitalit themeltare, jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave te kodit civil dhe atij tregtare.

Asambleja e ortakut te vetem ka te drejte te transferoje jashte territorit te Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e saj, perfshire edhe fondet e kontributet ne natyre.



Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltare duhet te jene te vertetuara me Akt-Noterial dhe per nje gje te tille asambleja e pergjithshme duhet te marre paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqeria dhe te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo tu behen te diture.

NENI 8

Kapitali themeltar I shoqerise mund te rritet ose zvogelohet, mbi bazen e vendimit me shkrim te asamblese se pergjithshme, vendim I cili nenshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bere dhe shenimet ne regjistrin perkates.

Me vendim te asamblese se pergjithshme, shoqeria ka te drejte qe nje pjese te kuotave te kapitalit themeltare t'ia tjetersoje nje apo disa personave fizike jashte shoqerise ose personave juridike, vendas apo te huaj mbi bazen e Aktit – Noterial, duke ju cenuar atyre dhe te drejten e qenies ortak ne raport me pjesen e kuotave te kapitalit te tjetersuar.

Çdo vendim I asamblese se pergjithshme per ndryshim te kapitalit themeltare I dergohet menjehere QKR-se.

NENI 9

Kapitali nuk mund te jete kurre I perfaqesuar me letra me vlere dhe derdhja e kapitalit themeltare te shoqerise, behet para kerkeses se drejtuar ne Q.K.R. per njohjen dhe regjistrimin e shoqerise si person juridik.

NENI 10

Pjeset e kapitalit themeltare mund tu transferohen te treteve teresisht ose pjeserisht.

NENI 11 ORGANET E SHOQERISE

Asambleja e pergjithshme eshte organi me I larte drejtues dhe vendimore I shoqerise dhe ajo ushtron te gjitha kompetencat qe ligji “Per shoqerite tregtare” I njeh asamblese se ortakeve.

Asambleja e pergjithshme mund t'ia delegoje kompetencat nje ose me shume administratoreve te caktuar prej saj ose dhe nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise, vetem mbi bazen e procures.

NENI 12

Me vendim te asamblese se pergjithshme shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqiptare apo te huaj, ose te bashkohet me nje shoqeri tjeter tregtare si Brenda dhe jashte vendit.

Organi vendimarrës I shoqerise, asambleja e pergjithshme, vendos:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- Emertimin dhe shkarkimin e administratoreve
- Mbi ndryshimet ne Aktin – Themelimit dhe Statut
- Mbi formimin e filialeve, degeve dhe perfaqesive jashte shtetit
- Mbi rritjen apo zvogelimin e kapitali themeltar
- Mbi ndryshimet ne object dhe mbi blerjen e pjeseve te kapitalit ne shoqeri te tjera
- Mbi transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar
- Mbi emertimin dhe revokimin e likuidatoreve
- Mbi menyren e operimit me mjetet financiare monetare
- Te tjera sipas ligjit

ADMINISTRATORI

NENI 13 Shoqeria administrohet nga nje administrator i vetem i cili eshte Medin Çulaj , atesia Haxhi , lindur 10.11.1951 , banues ne Shkoder me ltnj 028734538





Ky do te jete per nje afat 5 vjecar

EKSPERTI KONTABEL

NENI 14

Veprimet ekonomiko financiare te shoqerise, mbyllet me date 31 dhjetor te çdo viti  
Per nxjerrjen e rezultatit kontabel te shoqerise, mbi bazen e aktivitet dhe pasivitet ngarkohet nga asambleja e pergjithshme, nje ekspert kontabel i autorizuar

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dekomentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate lidhje me kontrollet

NENI 15

Nxjerrja e rezultateve te bilancit vjetor duhet bere me saktësi dhe duke respektuar te gjitha rregullat qe percaktohen ne ligjin per kontabilitetin dhe atyre te sitemit te taksave, qe jane te detyrueshme per tu zbatuar nga çdo subject privat qe ushtron veprimtari tregtare.

NENI 16

Bilanci kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim te asamblese se pergjithshme, e cila jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te veçante, etj.

NENI 17

Te ardhurat neto (dividendi) qe mbeten pas veçimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimit e pagesave ndaj te tretteve, I mbesin dhe I kalojne ne pronesi ortakeve te shoqerise, sado qofshin ato.

NENI 18 **PRISHJA E SHOQERISE**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çfare do shkakut, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar siç mund te jene: Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimet te metejshem te veprimtarise se saj. Nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per falimentimin".

Kur plotesohet afati I caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne keto raste asambleja e pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikohet menyra e likuidimit te shoqerise duke caktuar I (nje) apo disa likuidatore dhe duke shenuar ne çdo document te nxjerre prej tij dhe emertesën "shoqeri ne likuidim e siper".

NENI 19

Afati I emerimit te likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentet qe duhen depozituar ne aneksin e regjistrit ne Q.K.R.

NENI 20

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut, I referohet vendimeve plotesuese dhe te ligjshme te dhena nga asambleja e pergjithshme si dhe legjislacioni ne fuqi.

ORTAKU I SHOQERISE

Medin ÇULAJ



*Medin Çulaj*  
*Çulaj*

REPubLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE SHKODER  
Nr 3186 Rep, Nr. 2287 Kol

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

(Bazuar ne nenin 80-81 i Kodit Civil si dhe Nenit 55 te Ligjit mbi Noterine)  
Sot, me 14.07.2011 (katermbedhjete korrik dymije e njembdhjete) e Enjte ne  
Dhomen e Noterise me seli rruga "M.PIPA" Shkoder dhe para meje notere te kesaj zyre  
Valbona Hajdari, u paraqit personalisht:

Medin Çulaj , atesia Haxhi , lindur 10.11.1951 , banues ne Shkoder me ltnj 028734538  
ortak i vetem i shoqerise "DENIS-SH" shpk madhor me zotesi te plote juridike dhe per  
te vepruar I cili me vullnetin e tij te lire dhe te plote kane nenshkruar kete STATUT  
te shoqerise „DENIS-SH“ Shpk .

Ne keto kushte une si notere i vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

NOTE RE  
Valbona Hajdari

